



FEDERATA E SINDIKATAVE TË PAVARURA ELEKTROKOSOVA – FSPE
Federation of Independent Trade Union ElektroKosova - FITUE

Për: Zyra e Rregullatorit për Energji

Nga: FSPE

Komentet për këtë Raportin Konsultativ

Ne si FSPE, konsiderojmë që komentet tona si më poshtë janë më se të arsyeshme që të merren për bazë në plotësim-ndryshimin e të hyrave të lejuara për periudhën e dytë rregulluese për KEDS&KESCO.

Koment:

Pika 5, neni 5.1, shënimi për faktorin e efikasitetit prej 1.5 .

Ne konsiderojmë që kjo normë e efikasitetit prej 1.5 është shumë e lartë, marr parasysh se tashmë gjatë periudhës së parë rregullative është aplikuar një normë e efikasitetit prej 5 , e cila ka rezultuar në rënien e numrit të punëtorëve nga puna. Çfarëdo norme tjetër që do të aplikohet gjatë periudhës së dytë rregullative, do të ketë drejtpërsëdrejti efekt në rënien e numrit të punëve, sepse pagat e punëtorëve vlerësohen se përbejnë 80 % të shpenzimeve operative, apo rreth 22 mil€, e që i lë derën hapur apo i mundëson KEDS-it që çdo vit të largojë nga puna për rreth 60 punëtor dhe kjo është e papranueshme. Ju lutem keni parasysh se vetëm gjatë 5 viteve të para volumi i punëve është dyfishua dhe punëtorët e KEDS tashmë janë të mbingarkuar me punë. Ne kemi vërejtur që shpenzimet kapitale janë rritur për rreth 30 % krahasuar me periudhën e parë rregullative (2013-2017), gjatë se cilës periudhe shpenzime të realizuara ishin 100mil€.

Investimet Kapitale 2018 - 2022

Të dorëzuara nga KEDS						
Shpenzimet kapitale	153,859	28,921	36,385	38,314	27,130	23,108
Propozimet e ZRRE-së						
Shpenzimet kapitale	131,443	28,483	33,737	28,846	20,510	19,867

Investimet Kapitale 2013 - 2027

Investimet kapitale	€000s
PRR1 aprovuara	107,249
PRR1 realizuara	100,003

Rritja e investime kapitale nga 100 në 131.4mil€, përderisa shpenzimet operative pothuajse nuk kanë ndryshuar fare dhe për me tepër nuk përfaqësojnë as çerekun e shpenzimeve kapitale, do të na dëmtoj neve si punëtor sepse mungesën e punëtorëve, si rezultat i aplikimit të faktorit të efikasitetit KEDS do të kompensoj me punëtorë tjerë, respektivisht me kompani të kontraktuara, meqenëse KEDS ka të lejuara shpenzime kapitale për të paguar kompani të kontraktuar, ndërsa ne punëtorët do të dëmtohem jashtëzakonisht shumë. Ne këtë kuptim dhe marre parasysh zhvillimet e mëparshme, FSPE propozon si ne vijim:

Propozim i parë i FSPE-së:

1. Faktori i efikasitetit i propozuar prej 1.5 të jetë zero, pasi që vetëm kështu sigurohet një stabilitet tek punëtorët, së paku mos të ketë shkurtime të vendeve të punës, madje ky vlerësim nuk është real, që faktori i efikasitetit të njëjtë sikurse për KOSTT e cila kompani ka zhvilluar jashtëzakonisht shume teknologjinë e saj në 10 vitet e fundit krahasuar me KEDS, e cila thuajse ende nuk ka arritur ende te kaloj fazën tranzitore nga nje kompani publike në atë private me shërbim të publikut.
2. Shpenzimet tjera operative sipas viteve të njihen sipas propozimit tonë te paraqitur në tabelën e mëposhtme, e cila merr parasysh edhe nivelizimin e pagave. Ju lutem keni parasysh se në KEDS që nga viti 2013 ende ka me qindra vende pune të cilat nuk i kane te nivelizuara pagesat sipas pozitës, respektivisht ka punëtorë që punojnë ne te njëjtën pozite por dallojnë kanë nivele të ndryshme të pagave, e që përbënë diskriminim, de-motivim dhe sipas linjave buxhetore te propozuara këto dallime nuk mund te eliminohen, pa konsideruar dallimet ne pagesa ndërmjet nesh si punëtorë te një kompanie private dhe atyre qe punojnë ne te nijetin sektor por ne kompani publike.

€000s	2018	2019	2020	2021	2022
	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar	Propozuar
Të propozuara nga KEDS					
Shpenzimet tjera operative	23,592	23,854	24,240	24,628	25,058
Propozimet e ZRRE-së					
Shpenzimet tjera operative	21,418	21,152	20,892	20,637	20,387
Propozimet i FSPE-së					
Shpenzimet tjera operative	22,412	22,184	22,058	21,919	21,800

Koment:

Pika 8, neni 8.1,

Nuk ekziston asnjë mundësi apo matje reale e inflacionit, që Kosova të jetë njëjtë sikurse Eurozona pasi që Kosova ka ekonomi konsumuese dhe jo prodhuese, ne varemi nga importi i vendeve përreth, madje edhe inflacionin e "importojmë" nga ta kur dihet se Importi krahasuar me eksportin është në raport 1 me 9.

Shih tabelën e inflacionit në vendet e Ballkanit në tremujorin e dytë 2018 sipas Trading Ekonomiks:

COUNTRIES ▼	GDP	GDP YoY	GDP QoQ	Interest rate	Inflation rate
Albania	13	4.45%	1.15%	1.00%	2.30%
Serbia	41	4.80%	0.80%	3.00%	2.40%
Montenegro	5	4.50%			3.40%
Macedonia	11	0.10%	3.90%	3.25%	1.70%

Për më tepër edhe vlerat e inflacionit te njohura nga Banka Qendrore e Kosovës janë shume me te larta se ato te pranuar nga ZRRE. Ne mendojmë se është e padrejtë te aplikohet inflacioni i Eurozones, përderisa ne jetojmë dhe shpenzojmë ne Kosove.

Propozim i dytë i FSPE-së:

Ne konsiderojmë që matje reale e infalcionit në Kosovë duhet të jetë mesatarja e vendeve me të cilat kemi marrëdhënie të avancuar tregtare si: Serbia, Maqedonia, Shqipëria e Mali i Zi ku mesatarja e normës së inflacionit tek ta është 2.45 , sic u argumentua me larte, e jo ashtu siç është prezantuar nga ZRRE ne raportin konsultativ:

Linja	Njësia	Lejuar	HICP	Kostot e
OPEX-i	mil€	21.41	1.4	0.33
Zhvlerësimi	mil€	9.39	1.4	0.13
Kthimit	mil€	15.99	1.4	0.22
Total	mil€	49.20		

Punëtorët e KEDS tashme kanë qenë të ndëshkuar nga rregullatori gjatë periudhës së parë rregullative për aplikimin e normës së inflacionit sipas eurozonës, vlerat e të cilave ishin nën 0 , por e cila qasje besojmë se do të ndryshoj në vazhdim.

Duke ju falënderuar për konsideratën dhe mbështetjen tuaj të sinqertë, në raport me kërkesat tona të kahershme kundrejt institucionit tuaj edhe njëherë ju kërkojmë nga ju që të merrni për bazë këto komente tona reale dhe të matshme, në mënyrë që së paku neve si punëtorë mos të ndiejmë vetëm të anashkaluar dhe nëpërkëmbur.

Prishtinë më 05.09.2018

Kryetar i Kryesis FSPE
Hysni Gashi

Federata e Sindikatave të Pavarura ElektroKosova – FSPE Rr. Bill Clinton p.n. ndërtesa afariste Elektrokosova kati 2/7
Tel. + 381 (0) 38 79 14 64 ; 049 790 065 ; 049 799 372 Email adresa : fspe.hq@keds-energy.com; sindikatafspe@gmail.com